



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:034262

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06712562

P.nr.188/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrje e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.K nga fshati, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “*Pushtim i pasurisë së paluajtshme*” nga neni 259 paragrafi.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Pejë nën shenjën e PP-nr.1050/2007 të datës 26.06.2007, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 24.12.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarit E.S, përfaqësuesit të tij av.Mustafë Radoniqi, nga Peja, sipas autorizimit, të pandehurit Sh.K, dhe mbrojtësit të pandehurit av.Jeton Osmani nga Prishtina, sipas autorizimit, me datën 10.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.01.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

SH.K, i lindur më datë në, K. Pejë, i biri i S. dhe nënës T., e gjinisë....., me vendbanim në fshatin, rr., K. Pejë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin dega, posedon numër telefoni, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Në bazë të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

REFUZOHET AKUZA

Për shkak se:

Që nga data 18-19.06.2007 e gjerë më tani, në fsh. Lubeniq-KK.Pejë, ne kundërshtim me ligjin ka pushtuar pasurinë e paluajtshme ,pronën private qe është ne posedim të E.S në fsh....., në ngastrën katastrale mr nr.8 dhe 9 dhe me flete posedim nr.11 ZK, në atë mënyrë qe i

pandehuri ne mënyre arbitrare pa ndonjë autorizim, e ka pushtuar dhe e shfrytëzon këtë pronë dhe të njëjtën refuzon ta lëshon.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale **“Pushtim i pasurisë së paluajtshme”** nga neni 259 par.1 të KPK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

-Pala e dëmtuar E.S, fsh..... i Komuna së Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Pejë, tani Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të pandehurve Sh.K2 dhe Sh.K nga fsh.Lubeniç K.Pejë, ka ngritur propozim akuzë PP.nr.1050/2007, të datës.26.06.2007, për shkak të veprës penale **“Pushtim i pasurisë së paluajtshme në bashkëkryerje”** nga neni 259 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin P.nr.223/12 e dt.07.07.2023, ndaj të pandehurit Sh.K2 e ka pushuar procedurën penale dhe e ka hudhur pjesërisht propozim akuzën, ngase në shkresat e lëndës gjendet certifikata e vdekjes me nr. të referencës 17/2014RV/17002 e datën 27.02.2015, me të cilën vërtetohet se i pandehuri Sh.K2, ka vdekur me dt.14.03.2014, në fshatin Lubeniç ku edhe është varrosur.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin P.nr.223/12, të datës 07.07.2023, të pandehurin Sh.K e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale **“Pushtim i pasurisë së paluajtshme”**, nga neni 259 par.1 të KPK-së, duke i shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, e të cilin dënim me burg i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, duk e Obliguar të pandehurin Sh.K që të dëmtuarit E.S, t’ia liroj pronën, gjegjësisht ngastrat kadastrale nr.8 dhe 9 të evidentuara në fletën poseduese nr.11 –Z.K.Lubeniç, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm e nën kërcënim të përmbarimit.

Gjykatën e Apelit në Prishtinë, sipas aktvendimit PA1.nr.1100/23, të dt.18.12.2023, e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Sh.K av.Valmir Zhjeqi, duke Anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.223/2012, datë 07.07.2023 dhe këtë çështje penale i është kthyer gjykatës se parë në rigjykim dhe vendosje.

Meqenëse, kjo çështje penale është kthyer në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë, duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit ka caktuar seancat gjyqësore (rigjykim), me datën 11.04.2024, 13.05.2024, 20.06.2024, 30.07.2024, 19.09.2024. 22.10.2024, 25.11.2024 si dhe me datën 24.12.2024, dhe pas njoftimit të të pandehurit me të drejtat e tij, leximit të aktakuzës nga

ana e prokurorit të shtetit, meqenëse i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata këtë çështje penale e ka vazhduar me seancën e shqyrtimit gjyqësor edhe atë me datën 10.01.2025 në të cilën ka përfunduar dëgjimi i të dëmtuarit-dëshmitarit E.S.

Pas dëgjimit të dëshmitarit E.S, mbrojtësi i të pandehurit Sh.K av.Jeton Osmani, ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se: para se te vazhdohet me administrimin e provave konsideroj që fillimisht duhet të vendoset sa i përket çështjes procedurale përkatësisht parashkrimin të veprës penale meqenëse nga propozim akuzës shihet se përshkruhen veprimet nga data 18-19.06.2007 e deri me datën e ngritjes së aktakuzës përkatësisht deri me tani me datë 26.06.2007 e që duke pasur parasysh kohën e kaluar nga kjo date e deri me tani ku kemi mbi pesëmbëdhjetë vite të kaluara nga koha e këtyre veprimeve konsideroj se kemi parashkrim absolut të veprës penale nga neni 259 par. 1 i KPPK-së, në kohën e kryerjes së veprës penale dhe dënim për këtë vepër penale është maksimumi deri në një vit burgim e që në kuptim të nenit 90 par. 1 pika 6 të KPPK-së, vepra penale parashkruhet me kalimin e afatit prej dy vitesh sa i përket ndjekjes penale. Duke marr parasysh deklarin e vet palës së dëmtuar nga e cila shihet se ka një kohë të gjatë që nuk është shfrytëzuar prona sipas marrëveshjes së palëve, konsiderojmë se duhet që gjykata sipas detyrës zyrtare të vendos lidhur me parashkrimin, sepse konsiderojmë se vepra penale është absolutisht e parashkruar e kjo në zbatim të dispozitave të KPPK-së, i cili ishte në zbatim në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale.

Prokurori i shtetit lidhur me deklarin e mbrojtësit të pandehurit ka theksuar se duke marr parasysh se propozim përshkruar si kohë të kryerjes datën 18-19.06.2007, e gjerë me tani ndërsa datë e ngritjes apo përpilimit të propozim akuzës është 26.06.2007, konsideroj se mbrojtja me të drejtë pretendon me parashkrim të veprës penale për veprën penale e cila përfshihet në propozim akuzë, pasi që për PSH si datë e kryerjes së veprës penale konkurron data 26.06.2007, ndërsa vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri parasheh një maksimum të posaçëm në kohëzgjatje prej një viti burgim ndërsa për të shmangur përsëritjen e interpretimit të dispozitave të parashkrimin të veprës penale siç beri mbrojtja, dua vetëm te shtoj se sipas nenit 91 par. 6 të KPPK-së, si ligj i aplikueshëm në raport me kohën e kryerjes së veprës penale parasheh se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur te këtë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimin e çka në rastin konkret padyshim e se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar me tepër se katër vite ndërsa në trajtim të dëshmisë së dhënë nga i dëmtuari referuar marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejt ku i njëjti në pyetjen se kur për here te fundit është punuar toka nga i pandehuri përgjigjet para tri ose katër vitesh, përgjigje kjo qe krijon mëdyshje rreth këtij fakti pasi qe nuk gjen mbështetje në ndonjë prove tjetër e cila mëdyshje në kuptim të nenit 3 par. 2 të KPPK-së si parim duhet te interpretohet në favor të të pandehurit PSH konsideron se nuk ngrihet as niveli i dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri mund të këtë kryer vepër te re penale gjate kohës se zhvillimit te procesit gjyqësor.

Prandaj në prezencën e këtyre rrethanave referuar edhe parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshëm si dhe efikasitetit procedural sa i përket propozim akuzës nën shenjën PP-nr.1050/2007 të datës 26.06.2007, kundër të pandehurit Sh.K, për veprën penale “*Pushtimi i*

pasurisë se pa luajtshme”, nga neni 259 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, në pajtim me nenin 51 të KPRK-së tërhiqem nga ndjekja penale për të pandehurin Sh.K.

Meqenëse prokurori i shtetit ka hequr dorë nga propozim akuza nën shenjën e nr. PP-nr.1050/2007 të datës 26.06.2007, ndaj të pandehurit Sh.K nga fshati, i komunës së Pejës, për shkak të veprës penale “*Pushtim i pasurisë së paluajtshme*” nga neni 259 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, duke pas parasysh dispozitën e nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, e cila përcakton se: “*1.Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: 1.1 prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor*”, andaj shtuar këtu faktin se tërheqja e aktakuzës eliminon bazën juridike për vazhdim të gjykimit, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Konform nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

Në kuptim të nenit 462 par. 3 të KPPRK-së, i dëmtuari E.S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.188/24, me datë 15.01.2024.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjyqëse,

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.